



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE

Shqipëria, model suksemi në modernizimin e Shërbimeve Publike

2017-05-08 14:37:00



Modernizimi i Shërbimeve Publike në Shqipëri dhe ecuria e reformës së drejtuar nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito ka tërhequr vëmendjen jo vetëm të qytetarëve shqiptarë, të cilët dita – ditë po përfitojnë nga kjo reformë, por edhe të partnerëve tanë strategjikë.

Megjithëse ka vetëm dy vjet që ka nisur, ecuria e suksesshme e reformës në Shqipëri ka tërhequr vëmendjen e organizatave ndërkombëtare që e vlerësojnë atë si një model suksemi, që mund të shperndahet edhe në vende të tjera të botës.

Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito është ftuar nga PNUD dhe Banka Botërore të prezantojë reformën për modernizimit e shërbimeve publike në Shqipëri, përpara përfaqësuesve të rreth 20 vendeve të tjera të botës, të cilat janë duke projektuar zbatimin e një reforme të tillë.

Në konferencën ndërkombëtare me temë “Riorganizimi i ofrimit të Shërbimeve Publike”, të organizuar nga Qendra Botërore e Ekselencës së Shërbimeve Publike me qendër në Singapor dhe Banka Botërore, përfaqësuesit e PNUD dhe BB e kanë vlerësuar reformën në Shqipëri si një rast suksemi, që meriton të përhapet edhe në vende të tjera. Ministria Harito në fjalën e saj ka shpjeguar me detaje shtrirjen e reformës në drejtim të standardizimit dhe thjeshtimit të procedurave për marrjen e shërbimeve, në drejtim të ndryshimit të mënyrës se si trajtohen qytetarët në sportelet e ADISA dhe shërbimeve online.

“Reforma jonë e shërbimeve publike konsiderohet si një rast shumë i suksemi në disa kuptime: Në kuptimin e shpejtësisë së reformës, për faktin se kjo reformë prek të gjithë komponentët e shërbimeve publike, duke nisur nga standardizimi i tyre, përmirësimi i pritjes së qytetarëve, krijimi i qendrave të integruara thjeshtëzimi i procedurave, dixhitalizimi masiv dhe shërbimet online”, është shprehur ministria Harito pas konferencës.

Reforma e shërbimeve publike në Shqipëri përfshin pothuajse të gjithë sektorët, 20 institucione dhe 9 ministri. Aktualisht Agjencia e Shërbimeve Publike ADISA menaxhon sportelet e pritjes së qytetarëve në ZRPP Tirana, ka çelur dy qendrat e para me një ndalesë në Kavajë dhe Krujë dhe brenda muajit qershor do të vijojë me hapjen e dy qendrave të tjera në Fier dhe Gjirokastrë.